



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DREJTORIA E BADA, REGJISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më Dostavljeno	13/01/2025	
Njës.Lorg. Org. Jed.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
10-343	04-00023	88/25
PODUJEVË - PODUJEVO		



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM

Nr.01/2025
Podujevë

NJOFTIM

Në mbështetje të ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor, rregullorës komunale për transportin rrugor në territorin e komunës së Podujevës nr. 01-345/01-0008883/23 të datës 31 Janar 2023, rregullorja për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taxi të udhëtarëve nr. 01-345/01-0008882/23 të datës 31 Janar 2023, vendimit për caktimin e rrjetit të linjave urbane, urbano – periferike në vendbanimet rurale dhe orarin e qarkullimit nr. 01-345/01-0008885/23 të datës 31 Janar 2023, nenit 19 pika (1.14) dhe (1.6) të Statutit të Komunës së Podujevës, i miratuar me dt. 29 qeshor 2018.

Lajmërohen të gjithë operatorët të cilët ushtrojnë veprimatrinë e transportit të udhëtarëve në transportin urban, dhe urbano- periferik në vendbanimet rurale, duke përfshirë edhe Radio dhe Auto – Taxi, të cilët janë të pajisur me leje pune për vitin 2024:

Të aplikojnë për vazhdimin e lejeve të punës (rendit të udhëtimit) për vitin 2025 në linjat përkatëse.

Afati i aplikimit është deri me datën 27.01.2025

Dokumentacioni për aplikim merret dhe dorëzohet në zyrën për qytetarë.

Ndaj operatorëve të cilët nuk pajisen me vazhdimin e lejeve të punës (rendit të udhëtimit) do të merren masa ndëshkuese dhe parandaluese për ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

Podujevë
13.01.2025



Drejtori
Bahri Selimi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit

Nr. 01/2025

Podujevë, 13.01.2025

**DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM PËR VAZHDIMIN E LEJEVE TË PUNËS
PËR OPERATORËT ME AUTOBUS DHE MINIBUS PËR VITIN 2025**

1. Fletaplikacioni
2. Leja e punës për vitin 2024
3. Licenca e punës
4. Leja e qarkullimit të autobusëve -minibusëve
5. Polisa e sigurimit për autobusët-minibusët
6. Kontrollimi teknik i autobusëve-minibusëve jo më i vjetër se (6) muaj
7. Automjetet duhet të ketë kapacitet më shumë se 8 +1 ulëse
7. Leja e vozitjes për shoferët e kategorisë “D” dhe kontratat e punës për dy (2) shoferët
8. Certifikata e mjekut për shoferët e kategorisë “D”
9. Të mos ketë pengesa juridike për kompanitë e autobusëve-minibusëve
10. Të mos ketë pengesa juridike për shoferët e kat. “D”
11. Certifikimi i autobusëve-minibusëve
12. Të ketë dëshmi mbi kryerjen e obligimeve mbi taksën komunale.

FLETAPLIKACION

Kompania:
Adresa, nr. tel:
Relacioni:
Koha e nisjes:
Koha e kthimit:

	Autobusi- Minibusi	Autobusi rezerv:
Nr.i regjistrimit:		
Tipi:		
Viti i prodhimit:		
Destinimi :		
Nr. Ulëseve :		
A ka klimë:	PO JO	PO JO
Certifik.Autob:		
Kom.Sigurime :		



Republika e Kosovës /
Komuna e Podujevës

Republika Kosova /
Opština Podujevo



Republic of Kosova
Municipality of Podujeva

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM PËR KRYERJEN E TRANSPORTIT ME TAKSI TË UDHËTARËVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2025

KUSHTET PËR APLIKIM

A) Transporti taksi i udhëtarëve-personat fizik:

- të ketë vendbanim në territorin e komunës së Podujevës
- të jetë pronar i automjetit me të cilin ushtron këtë veprimtari,
- të ketë fotokopjen e policës së sigurimit
- të ketë lejen e drejtuesit të kategorisë „B”
- të ketë së paku 5 (pesë) vite patentë shofer
- të ketë biznesin e regjistruar
- të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë për TAKSI drejtues
- të ketë dëshmi mbi kryerjen e obligimeve mbi taksën komunale
- të ketë certifikatën mjekësore
- të ketë njohuri për qytetin
- leja e punës për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse për vitin 2024

Automjeti, përveç kushteve tjera të përcaktuara me ligj, duhet të plotësojë edhe këto kushte:

- të ketë së paku katër (4) dyer
- të ketë më së shumti 4+1 ulëse
- të ketë të vendosur mbi automjet shenjën “TAXI” ose „RADIO-TAXI”, e cila duhet të ndriçojë natën
- automjeti duhet të jetë jo më i vjetër se viti 2000

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën pritëse, të adresuara për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

B) Transporti taksi i udhëtarëve –ndërmarrja

- të ketë licencë për këtë lloj transporti
- të ketë selinë në territorin e komunës së Podujevës
- të ketë certifikatën e regjistrimit të biznesit
- të ketë së paku 3 automjete në pronësi, të cilët duhet të jenë me ngjyrë të njëjtë
- të ketë së paku 3 (tre) shofer të punësuar, të cilët posedojnë lejen e drejtuesit të automjetit, të kategorisë „B”, më të vjetër se 5 vite
- të ketë leje qarkullimi për të gjitha automjetet në pronësi, të cilat duhet të jenë të një lloji, me ngjyre të njejte ,
- Automjetet të jenë të paisura me taximetra
- të ketë vendqëndrim dhe sistemin e radiolidhjeve
- të ketë librezën e qarkullimit
- fotokopjen e policës së sigurimit
- certifikatat mjekësore për shoferët
- të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë për “TAXI”ose,,RADIO-TAXI” drejtues
- të ketë dëshmi mbi kryerjen e obligimeve mbi taksën komunale.
- leja e punës për ushtrimin e veprimtarisë përkatse për vitin 2024

Aplikacionet mirren dhe dorëzohen në Zyrën Pritëse, të adresuar për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

C) Kompanitë e licencuara “radio taxi” dhe me leje veprimi brenda territorit të komunës së Podujevës, në kushte të njëjta mund të aplikojnë për shtim të Automjeteve deri në 5 (pesë) automjete

Vërejtje: numri i automjeteve duhet të jetë i barabartë me numrin e shoferëve të punësuar



Republika e Kosovës /
Komuna e Podujevës

Republika Kosova /
Opština Podujevo



Republic of Kosova
Municipality of Podujeva

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

Nr. 01/25

Podujevë, 13.01.2025

FLETAPLIKACION

Emri dhe Mbiemri i aplikuesit Auto – Taksi dhe Radio – Taksi
Adresa dhe nr. tel:
Vendparkimi – Vendqëndrimi :
Orari i punës :

Nr. i regjistrimit:

Tipi

Viti i prodhimit:

Destinimi:

Nr. i ulësve

A ka klimë?

Komp. E sigurimeve :

Automjeti :	
PO	JO